

VITI XV, NUMRI 10 / TETOR 2011

FOREVER



HUNGARY | ALBANIA | BOSNIA AND HERZEGOVINA | CROATIA | MONTENEGRO | SERBIA | SLOVENIA





Ndryshim!

Nayrisht ndryshimi ishte në rendin e ditës në Super Rally-in e mrekullueshëm të Washingtonit. Fola për ndryshimin të premtën në mëngjes dhe desha të shpenzoj vetëm një minutë për të ritheksuar mendimet e mija për këtë çështje të rëndësishme.

Sikurse e kam theksuar edhe më parë, ndryshimi ndodh kudo rreth nesh: në biznesin tonë të përditshëm, në familjet tona dhe praktikisht në çdo aspekt të jetës tonë. Shpesh njerzit i shmangen ndryshimit nga frika e të panjohurës ose nga dashja e rehatit. Ashtu si personazhi i librit të Dr Spencer Jonson „Ku shkoi djathi im”, një libër që ua rekomandoj të gjithëve ta lexoni, ne ose mund ta parashikojmë dhe perqafojmë ndryshimin ose ne mund ti trembemi atij dhe nuk e pranojmë. Por mos harroni kurrë se ky ndryshim do të vijë pamvarësisht se si reagojmë ne, dhe vetëm duke e pranuar atë dhe duke u angazhuar në mënyrë efektive me të ne mund të ecim përpara me sukses.

Unë jam shumë i entuzizuar për ndryshimet që ne po bëjmë për ta çuar dhe fokusuar biznesin tonë në nivele krejt të reja suksesi. Unë besoj vërtet se kalimi në një Global rally në vitin 2013 dhe futja e programit Profit Sharing me 2 pikë ka mundësinë të sjellë një sukses masiv.

Futja e programit Profit Sharing shumë vite përpara ishte një faktor i rëndësishëm për sukseset që ne kemi arritur deri tani. Gjatë këtyre veteve ne kemi shpërblyer me 100 milion dollarë duke i rikthyer ato tek ju, dhe mua më gëzojnë efektet që ka patur ky program në jetën tuaj. Programi Profit Sharing ka realizuar atë që ne shpresonim e ca më shumë. Por mundësit janë dhe momenti ka ardhur që këtë program dhe Rally-in tona ta çojmë në një nivel tjetër. Ne kemi patur parasysh mendimet e dhëna nga ju dhe besoj sinqerisht se kjo është një lëvizje e drejtë e Forever Living Products dhe momenti i pershtatshëm për tu ngjitur në lartësi të reja. Në mesin e një bote biznesi të mbushur me dështime, Foreveri ka qënë dhe do të jetë shtyllë force dhe stabiliteti. Unë kam besim tek ju. Unë kam besim tek i gjithë personeli i kompanisë tonë të madhe dhe unë kam besim se programi Profit Sharing 2.0 dhe Global Rally do të na futin në të ardhmen në një rrugë suksesesh edhe më të mëdha.

Jam shumë i entuziazuar kur mendoj për ardhjen tuaj në Phoenix, për Super Rally-in e fundit ndërkombtar në gushtin e vitit të ardhshëm. Unë e dua Arizonën. Unë mendoj se nuk ka vend më të mirë për të krenuar këtë fillim të ri, këtu ku e nisëm 33 vjet më parë.

Ju lutem të merrni me vete gjithshka mësuat në këtë Super Rally dhe shkoni dhe mbyllni vitin me sukses. Nga 2011 kanë mbetur vetëm 4 muaj; mos i lini ata tju ikin kot dhe të vini në dhjetor pa realizuar gjithë objektivat tuaja. Unë e di se shumë nga ju kanë punuar shumë dhe kanë ecur me vrull për të qënë një vit i madh.; por unë jam i sigurtë se ju keni shumë më tepër mundësi se sa mendoni.

Dëshiroj tju falnderoj që jeni pjesë e Foreverit dhe që e keni kthyer këtë në një nga mundësitë më fantastike në botë.

REX MAUGHAN
I JUAJI PËR JETË



FOREVER

FOREVERI - BIZNESI I SHEKULIT XXI

Media vazhdimisht na bën të ditur për krizën ekonomike, për krizën e sistemeve financiare, për xhiron e ulët, pra praktikisht për një situatë krize botërore. Dhe në fakt në qoftë se shikojmë televizionin, dhe çdo ditë marrim këtë informacion, atëhere mbas një kohe do të besojmë që edhe neve do të jemi të vuajturit e kësaj situatë, dhe le të presim kurd o të na vijë radha. Por ka edhe mundësi zgjedhje. Ta stakojmë televizorin, të mos i dëgjojmë lajmet- unë personalisht tash prej vitësh kështu jetoj dhe vërtet nuk e ndiej mungesën sepse jetoj në një sistem krejt tjetër. Në një sistem që e quajmë Forever Living Products. Faktikisht kjo është një sipërmarrje biznesi, një sistem i mendjes të persosur, i cili realizon një shëndet mendor e social dhe krijon një mirqënie materiale. Dhe në fakt gjithkush për këtë ka nevojë.

Të gjithë duam veshje të reja, të blejmë makina të reja, shtëpi të reja, të shpenzojmë për vila, të ndërrojmë vazhdimisht paisjet shtëpiake, ti rritim fëmijët të lumtur dhe ti arsimojmë në shkolla të shkëlqyera.

Çfarë tu trashëgojmë brezave të ardhshëm? Çfarë të ardhme do të mund të sigurojmë për ta? Brezin e ri, dhjetë-njëzetvjeçarët tashmë nuk i nxit dhe nuk i motivon i punësuar „sklav” për dyzet vjet radhazi.

Gjithkush dëshiron një karrierë të shpejtë dhe të sigurtë dhe një jetë materiale shumë të mirë dhe të qëndrueshme.

Pra cila është zgjidhja: stako televizorin, dhe tako marketingun në rrjet (MLM), ky është drejtimi i shekullit XXI. Tashmë atë e njohin shumë vetë: sipërmarrës të vegjël, sipërmarrës të mëdhenj tradicionalë, punëtorë, nëpunës, mjekë... tashmë ky sistem u ka dhënë atyre mundësinë.

Si të njiheni me të? Atëhere merr pjesë vazhdimisht në takimet tona, mëso, sepse vetëm kështu do të mund të zgjerosh njohuritë e tua, që janë baza e këtij biznesi fantastik. Zhvillo aftësitë e tua të komunikimit me njerzit, dhe praktiko aftësitë organizuese çdo ditë dhe në çdo moment.

Për çdo njeri vlera më e rëndësishme është koha. Këtë thesar të çmuar që nuk mund ta ndalojmë, na duhet të vendosim si do ta jetojmë, çdo minutë dhe çdo sekondë. Mundet me nivelin e deri tanishëm të të jetuarit, me hallet e deritanishme, por edhe mund të heqim një vijë ndarëse dhe mbi podiumin e sigurisë të vendosim shpresën, mirqënien, bukurinë dhe shëndetin.

Mos nguro, vendos siç duhet. Përpara teje ke mundësinë; anija e Foreverit është nisur në kursin e vet me synime dhe objeta të vetëdijshme. Për secilin është e lirë hypja në këtë anije, çështja është vetëm se kur do ta presësh biletën. Kjo anije me ty apo pa ty ecën përpara dhe vazhdimisht me shpejtësi gjithnjë e më madhe.

Hyp në këtë anije, bëhu anëtar i skuadrës më fitimtare në botë, mëso nga biznesmenët, nga rrjetndëruesit më të mirë në Europë dhe suksesin do ta kesh të garantuar.

Përpara FLP!



DR. SÁNDOR MILESZ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Success Day

BUDAPEST 17 SHTATOR

DITËT E SUKSESIT GJITHMONË TË KRIJOJNË NJË LLOJ NDJENJE LIRIE. SEPSE FOREVER LIVING ANËTARËVE TË SAJ GJITHMONË U OFRON: LIRINË EVENDIMIT DHE PASTAJ VETË JETËN E LIRË. EDHE TAKIMI I SIVJETËM NË AMERIKË HODHI NJË PARULLË TË RE: „BE FREE”, DOMETHËNË JI I LIRË!

S ë pari edhe drejtuesit e programit zafir menaxherët **Istvan Halmi dhe Rita Mikola Halminé** na kujtuantakimin në Amerikë, World Rally-in. Foreveri i Hungarisë ishte midis më të mirëve, dhe shumë midis tyre janë këtu me ne. Me kërkesën e Istvanit, ngrihen nga vendi dhe ti shikojmë të gjithë ata njerëz të sukseshëm, që morën të ardhmen e tyre në duart e veta, të cilët ndihmojnë edhe të tjerët të ndihen mirë dhe që edhe materialisht tu dalin llogaritë.


Pas ngjitjes në skenë të drejtuesve më të sukseshëm, **Dr. Sándor Mílesz** ashtu siç e ka zakon, falënderon ata që kanë ardhur për herë të parë në këtë takim. „Keni marrë një vendim të drejtë” - ju thotë drejtori i pergjithshëm, pastaj shpall rezultatet e konkursit të dytë të vizatimit për revistën Forever Kids. Këtu çdo fëmijë kopshti apo shkollë fillore, është një ndërtues rrjeti i mundshëm nesër, „ata do të jenë një Miklós Berkics Miklós, Aranka Vágási apo József Szabó i ri” – thekson Sándor Mílesz . Pastaj kalon tek problemet e më të rriturve „FLP është bërë një firmë globale, jo vetëm në kuptimin gjeografik, por edhe se mënyra e të menduarit të njerzve këtu është globale” Prej 13 vjetësh jemi në dhjetëshen më të mirë të botës, ndërsa aktualisht jemi të gjashtët në botë.”



Në këtë kuptim kanë ndryshuar kushtet e kualifikimit , që nëkuptojnë vetëm sfida pozitive të reja, mbasi edhe ata që fillojnë tani, jaë tamam në kohë, „deri në dhjetor kushdo mund të arrijë nivelin e drejtuesit apo mund të arrijë 1500 pikët”-shprehet ai. „Këto nuk janë gjëra të pamundura” – thotë Dr Sándor Milesz, pastaj përmend Klubin e Conquistadorëve” „anëtarët e këtij klubi ndryshojnë nga të tjerët vetëm sepse mësojnë shumë”. Ky është një

profesion që edhe ju duhet ta mësoni. Duhet krijimtari, shumë mësuarje, atmosferë pztitive, talent dhe komunikim i mirë me njerzit. Tash shtërngoje këtë sipërmarrje, mbasi këtu gjithshka është për jetën të. Kur të mbarojnë leksionet, ju uroj që sponsorit të marrin shumë përgjigje pse dhe në çmënyrë funksionon...”

Dr. Judit Végh – menaxhere eshte e para në vargun e lektorëve, duke filluar me temë profesionale: përgatitja për muajt e dimrit. Sa më shumë afrohet i ftohti , një rol aq më të madh sistemi ynë i imunitetit. Por nuk ka nevojë që këta muaj të jenë „të sëmurë” Sipas Judit Végh, edhe në këta muaj mund të jesh plotë dritë dhe energjike. Por eshte fakt se në periudha të tilla lëvizjet janë më të pakta, ajri i pastër apo frutat e zarzavatet e





freskëta janë më të pakta. Prandaj ka rëndësi që krahas mbrojtjes natyrale ta shoqërojmë edhe me një mbrojtjetë organizuar. Qelizat mbrojtëse, antioksidantët edhe flora e zorrëve marrin funksione komplekse. Pas kësaj vazhdoi kualifikimi i supervizorëve, asistent menaxherëve dhe Conquistadorëve. Ishin aq shumë sa secili mundi të thoshte vetëm nga një fjalë falnderimi. „Djema, duhet të realizojmë planin! Besoni, ju jeni më të mirët, sepse po ta llogarisim për frymë popullsie ne realizojmë xhiron më të madhe në botë” - thotë **Tibor Elias**. „Kisha një vizion timin..., nuk isha midis Conquistadorëve. Por tani e kam menduar se vera nuk do të flas për pushime. Ky është thelbi. Duhet ndryshuar. Nuk duhet ankuar por duhet ecur perpara me një skuadër fantastike” - thotë **Renata Zsidai**. Pastaj vjen këshilla e urtë. „Ejani me ne, sepse është mrekulli!. Shumë kohë qëndrova e frenuar, por pastaj brënda një viti u bëra menaxhere!” „Eshtë shumë e thjeshtë, bëni të tuat vetitë që dëgjoje këtu dhe do të kesh sukses!” „Gjithmonë përqëndrohu në objektivin që vjen pas!”. Këtë thonë të kualifikuarit, këtë themi ne të gjithë që i jemi mirnjohës FLP- gati të gjithë përmendin skuadrën , sepse pa të askush nuk do të kishte sukses! Këtu kështu punohet

Falnderimet nuk kanë fund, shumë japin edhe dhurata. Shpërblimi i një të kualifikuari është një bicikletë malore, ndërsa me rastin e ditëlindjes të nënës të István Halmi, merr ndoshta gjënë më të bukur: lui këndon për të pjesën e Péter Máté „akoma nuk të kam falnderuar që jetoj...”

Ágnes Krizsó - zafir menaxhere, nuk e ka të lehtë të marrë fjalën, sepse i duhet të mendojë edhe për ata që fillojnë ndërtimin e rrjeteve. Çfarë duhet për këtë? Vendosmëri, përkushtim, guxim, modesti, objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.





Por tej faktorëve racionalë, Agnes përmend rolin e ëndërrave. Sikurse thekson ajo, ka nevojë për vizione me hapa të mëdha por të planifikueshme, dhe për durim të shkallës më të lartë. Domethënë është një veprimtari e vazhdueshme cilësore përmes niveleve të përditshme dhe mënyrës të jetesës. Sepse mënyra e jetesës është ajo që i tërheq të tjerët, edhe për ata që mundësisht do të lidhen me FLP. „Gjurmë për një kohë të gjatë duhet të lëmë tek ata që na pasojnë, sepse kemi përgjegjësi për ta. Por vetëm ata mund të ndihmojmë, të cilët duan të ndryshojnë dhe që nuk duan të vegjetojnë në zonë e rehatit”.

Nuk munguan as momentet prekës, por tash shumë vetë nxjerrin shamitë e xhepit: Caramel, zbuluesi i Megastarit ngitet në skenë me shfaqjen plot talent, pastaj përsëri vazhdon falnderimi festiv: kualifikimi për Holiday Rally, kualifikimi i 60 pikshave, i Conquistadorëve, i menaxherëve, i targave të makinave të FLP Renáta Zsidai, merr fjalën për së dyti, për të falnderuar mbasi u titullua senior menaxhere. „nëna më tha, mos ki frikë, gjeje vëndin tend, atje ku respektohen nderi, respekti e dashuria. Kishte të drejtë sepse u takova me njerëz të mëdhenj këtu në FLP, dhe tani ka filluar puna...”

„U mbushën 4 vjet, por për asnjë minutë nuk më vjen keq, sepse tash e kuptoj. Eshhtë momenti më i bukur i jetës time, krenare dhe e kënaqur jam për të, dhe kjo është një gjë e rrallë për mua” – thotë senior menaxheri **János Tóth**.

„Kjo është një mundësi që të bën të lumtur, të pasur dhe të shëndetshëm” – thekson senior menaxheri **Gabor Oláh**.





Menaxheri **Balázs Bársony** punon me rrjetin prej 5 vjetësh dhe për herë të parë u jep leksion në Ditën e Suksesit të tjerëve për fillimin e punës dhe për takimet me njerzit.

„Ajo që është më e rëndësishme me këtë rast thotë Balázs, është mesazhi që transmeton **Rex Maughan** për njerzit dhe që është një nga recetat më të mira, por e rëndësishme është ajo që kushdo ta përfshijë veten, sepse prej kësaj mesazhi bëhet një dhe i veçantë”. Edhe Balázs ka Recetën e tij serioze: Harmonizim, përshtypje e parë, objektiva, Përkushtim, Informim profesional, Mësuarje. Mundëm të shikonim edhe një video për gabimet tipike, dhe në fund Balázs u kërkon të gjithëve të shkruajnë në letër datën kurd o të bëhen menaxherë.

Asistent supervisorët afrohen gjithnjë e më shumë. është radha e kualifikimit të tyre, pastaj **Aranka Vágási** - diamant menaxhere, tërheq vëmendjen se „atë që mëson këtu duhet tua përcjellësh të tjerëve. Motivimin më të madh e kam marrë në Amerikë kur drejtuesit e FLP, dërguan për ne 4 avionë të veçantë për të na shpëtuar nga stuhia”- tregon ajo, „ndërsa Rex Maughan dhe drejtuesit e tjerë të FLP u larguan me avionin e fundit. Atëhere, atje morëm një forcë të pabesueshme”.

Aranka, krahas forcës, thekson dashurinë për produktet, siç thotë ajo, kjo është baza e gjithshkaje. „E kam ditur ku doja të arrija dhe për vlerat e veçanta të biznesit të Foreverit. Jastzakonisht shumë





familjeve u jep shpresë dhe gjithshka tjetër! Gjithkujt i uroj të gjejë objektivin e tij dhe atë që e motivon. Sepse është një ndjenjë shumë e mirë të japësh dhe të marrësh vlerësim e mirënjohje”.

Lektori i fundit i ditës së sotme, ishte soaring menaxher **Tibor Lopicz**. Ai mbyll ditën të cilën e hapi vajza e tij e vogël Anna e cila u ngjit në skenë bashkë me grupin e valltarëve profesionistë në fillim të këtij takimi. „ Jetoje i lirë jetën tënde, jetën e Foreverit” – thotë Tibor në leksionin e tij. Nuk e harron këtë ditë të 9 vjetëve më parë, kur erdhi në një takim të tillë dhe vendosi, që kjo do të jetë rruga e tij. „ ka nga ata që sot do të vendosin, që ta fillojnë apo ta rifillojnë. Në fakt duhet të marrësh nga koha e lirë, vërtet do të ketë netë kur nuk do të jesh me familjen, por është një diçka për një gjë të rëndësishme. Sepse sot ndoshta punon në një vënd pune, por nuk ke sigurinë e vertetë. Në këtë biznes duhet investuar punë dhe kohë që të mund të bësh një jetë cilësore që gjithkush e ëndërron, i lirë, me pavarasi materiale dhe i shëndetshëm. Be free, Ji i lirë! Kjo sipërmarrje të bën të lirë. Mos harro : nuk e arrin suksesin ai njeri që je, por ai që do të bëhesh!



U MBUSH EDHE NJË VIT, ERDHI PËRSËRI KOHA E SUPER RALLY-IT. MADJE KËTËVIT ME DHURATA TË REJA !

Para 3 vjetësh kur e filluam këtë biznes kishim qëllim pasurimin, të ndërtonim një biznes që vërtet ta shpërblen dhe të mund të futëshim në rrethin e ngushtë të distributorëve kryesorë. Në vitin e tretë të jetës tonë në Forever u kualifikuam edhe për programin stimules Eagle Summit, ku vend i zhvillimit të aktivitetit do të ishte New York. Një qytet që nuk fle kurrë, ku graticelet ngjiten në pafundësi, me turmat që vërshojnë në sheshin Time Square, me Wall Street-in, me bustin e Lirisë, me Fifth Avenue, me Central Park-un, me taksitë e verdha që nuk vonojnë, ose siç i quajnë ata „yellow cab”, me teatrin Broadway, me Empire State Building, apo qëndrën Rockefeller Center. NYC, sië e përmendim, ofron shumë programe, përshembull një numur të pafund restorantesh, por çështja më e rëndësishme gjithmonë është me kë dhe tek kush e kalon kohën.


Sponsori ynë Miklós Berkics prej vitësh është pjesmarrës i rregullt i programit të veçantë Eagle Summit, prandaj ai është atje duke u përgatitur si do ti zbukurojë me garniturë detyrat interesante të këtyre ditëve.

Gjatë jetës sonë kemi shkuar në shumë vendet e botës, sigurisht edhe në New York në disa raste, megjithatë këtë takim e prisim me emocion, mbasi nga të gjitha rastet e tjera për ne është më i vecantë. Me një nderim e kujdes të vecantë na pritën drejtuesit e firmës. Çdo vit i kushtojnë një kohë të vecantë trainimit të drejtuesve që kanë arritur rezultate më të larta. Në këto krahas shprehjes të vlerësimit ofrohet edhe një zhvillim krijues, duke u dhënë kuptim detyrave të vecanta.

Qyteti në vetvete është magjepsës, por gjithë kësaj kulmin e arrin me kompaninë Forever, ku zëvendës presidenti i firmës për kontinentet dhe personalisht Gregg Maughan na tregoi mundësitë që ofron New Yorku për një lojë që kërkon intuitë.

Paraditja na kaloi me njohjen e risitë e produkteve që së shpejti hedh në treg Foreveri si dhe me ideimin e programeve stimules të reja globale, ndërsa mbas dite filloi gara ndërmjet skuadrave. Vetët na u vu një detyrë e vecantë që vetëm me shfrytëzimin e mjeteve të vecanta mund ta zgjidhnim, dhe e cila për hir të lojës së ndershme „fair play” duhej edhe ta dokumentonim. Në New York në vend të strechimo që mund të merret me qira, mund të lëvizësh edhe me autobus, me metro apo në këmbë, dhe nqse bie shi kjo sidoqoftë kërkon modesti, kryesisht për më tepër në qoftë se ta lejon diamanti apo xhepi yt.

**EAGLE
SUMMIT
NEW YORK**





Falë rregullave mundëm të provonim, çfarë ndodh kur diçka për dy orë radhazi ka difekt dhe mbetesh në metro, ku për më tepër temperatura në stacion arrin 45 gradë, kurse në vagonat e metrosë vetëm 18 gradë. Shijum hotdog-et e vërtetë që shiten në rrugë, mundëm të ngjiteshim në taracën e ndërtesës më të lartë të qytetit, që prej andej të dërgonim një mesazh frymëzues, ndërkohë që ret u ulën në taracën e graticelit gjithandaj shikonim retë ngjyrë qumështi. Mund ti rreshtojmë detyrat, por fakti është që ishim sipas skuadrave, u argëtuam, por ndërkohë dëshira për të fituar, na bëri që të ruajmë fokusimin. Pjestari vendimtar i skuadrës tonë ishte Dr Sándor Milesz, drejtor i pergjithshëm, kujdestari i përjetshëm, i cili ishte në gjëndje të na nxirrte edhe nga situata më të papritura.

Kurora e programit tonë të ndërtimit të skuadrës ishte kur në kuadrin e një programi përkujdesje që tashmë funksionon tradicionalisht edhe në firmën tonë hëngrëm darkë në një qëndër të ushqyerjes të të pastrehëve. Një ndjenjë që të bën të mendosh dhe të shkundesh, se fati për shkak të ndonjë kthese të papritur, mund të përmbysë jetë njerzish e familjesh.

Natyrisht shijum edhe jetën artistike të qytetit si dhe nga pikpamja e gastronomisë. New Yorku është shëmbull i asaj ku endërrat bëhen realitet, nqse dikush do vërtet, sepse një pjesë e mirë e këtyre godinave monumentale është ndërtuar pikërisht në atë periudhë (1929-1933) kur bota përjetonte krizën e atëhershme më të madhe botërore.

Attila dhe Kati Gidófalvi - diamant menaxherë



NË 2013 BËHU PJESË E DIÇKAJE MADHËSHTORE, E FOREVER GLOBAL RALLY-T !



Në 2013 mund të jemi dëshmitar të Forever Global Rally-t të parë, të një evenimenti të tillë, me të cilin unifikojmë të gjithë rally-t rajonalë në një program të vetëm madhështor. Kjo është një mundësi e madhe për atë, që mund të takohemi me më të mirët e biznesit, që mund të marrim pjesë në trajnime të përkryera dhe të përpunuara, dëshmitar të klasifikimeve më të mëdha dhe të mund të jemi pjesë e takimeve akoma më të mëdha.

Ata, që klasifikohen në Forever Global Rally, i çojmë në vende unike dhe të veçanta, ku ju prezantojmë konceptin e biznesit tonë, sipas së cilit nuk ka kufizime, sepse ky është një biznes që nuk ka kufinj!

SI MUND TË KLASIFIKOHESH?

Kushtet e klasifikimit në Forever Global Rally janë të thjeshta. Në një vit kalendarik realizo 1500 cc ose klasifikohu për Profit Sharing. Po, kaq! Rregullat nuk janë të komplikuar, nuk ka pjesë me gërma të vogla. Në një vit klasifikohu me 1500 pikë ose Profit Sharing dhe për të tjerat mendohemi ne.

ÇFARË MUND TË PRESËSH PREJ SAJ?

Që një distributor, sa shumë gjëra përjeton në Forever Global Rally-n, kjo varet nga sasia e pikëve që bën në një vit. I klasifikuari me 5000 ose më shumë mund të kalojë 9 ditë në vendin aktual ku bëhet rally, të klasifikuarit midis 2500 dhe 5000 8 ditë, ndërsa 1500-2500 pikëshit mund të shijojnë 6 ditë qytetin ku zhvillohet rally.

Po ku do të jetë vendi i Forever Global Rally-t të parë? Këtë akoma nuk mund ta themi, por mund t'ju premtojmë, që mund të llogarisni habi madhështore, ekskluzive dhe luksoze!



PLANIFIKIMI I PROGRAMIT PËR FOREVER GLOBAL RALLY 2013:

FOREVER 
GOING GLOBAL
Coming 2013

E DJELË - DITA E PARË

Mbrritja e të klasifikuarve me 5000 ose më shumë dhe darka e nderit

E HËNË - DITA E DYTË

Trajnim për ata që janë klasifikuar me 5000 ose më shumë cc
mbrritja e të klasifikuarve me 2500-5000 cc

E MARTË - DITA ETRETË

Trajnim për të klasifikuarit me 2500 - 5000 cc
Mbrritja e të klasifikuarve me 1500 - 2500 cc & darka e nderit
Të klasifikuarit me 1500 -2500 cc mbasdite kanë program të lirë
Të klasifikuarit me 5000 cc ose më shumë kanë gjithë ditën program të lirë

E MËRKURË - DITA E KATËRT

Trajnim i veçantë për të klasifikuarit me 1500 cc

E ENJTE - DITA E PESTË

Prezantim i produkteve të reja dhe trajnim

E PREMTE - DITA E GJASHTË

Dita e parë e Forever Global Rally & Profit Share

E SHTUNË - DITA E SHTATË

Dita e dytë e Forever Global Rally

E DIËL - DITA ETETË

Kthimi në shtëpi i të klasifikuarve me 1500-2500 cc
Program i lirë për të klasifikuarit me mbi 2500 cc

E HËNË - DITA E NËNTË

Kthimi në shtëpi



FOREVER 
GOING GLOBAL

AMERICAN dream

Ëndërra amerikane

Tashmë që nga Prilli dihej se ata që kishin plotësuar 5000 pikë mund të niseshin për në Super Rally, kështu që jo vetëm shpenzimet e udhëtimit por edhe të strehimit e ushqimit do ti përballonte firma, por na dhanë edhe nga 2000 dollarë si pare xhepi.

Stacioni i parë ishte Washingtoni, këtu u organizua Super Rally. Që nga momenti i mbërritjes shijua shërbimin e plotë si VIP-a, sepse të gjithë ata me mbi 5000 pikë gëzonin këtë shërbim.

Në seminar sundonte një atmosferë e pabesueshme, gjithkush priste me kuriozitet cilat do të jenë të rejtat e këtij viti dhe të vitit të ardhshëm. Që në fillim dëgjua cilat do të ishin ndryshimet, çfarë perspektivash i caktojnë ndërtimit të biznesit jashtë vendit, dhe që në fillim mundëm të provonim produktet e reja. Shumë ngjyra të papara u shpalosën në skenë, por për mua një krenari e veçantë ishte ajo që kur ndërmjet 4 diamantëve të rinj të botës, dy ishin hungarezë. Ata ishin Miklós Berkics dhe prindërit e mi Attila dhe Kati Gidófalvi. Nuk mund ta shpreh me fjalë atë që kam ndjerë, kur diamantët e rinj e rinj u ngjiten në skenë me 10000 pikë, edhe tani më ngjethet mishtë. Mbushesh me ndjenja të bukura, kur e gjithë bota e FLP mund ti njohë ata!

Të dielën u nisëm për në Post Rally-in tradicional. Na çuan me autobus tek avionët e marrë me qira dhe mundëm të udhëtonim si miq VIP-a bashkë me Rex Mundëm të njohim një anë tjetër nga ajo që kishim parë deri tani në skenë. Provuam personalisht takimin dhe devocionin e drejtpërdrejtë.

Ndalesa e dytë ishte Dallasi. Ndërsa mbasdite morëm pjesë në shfaqjen Rodeo në fermën në Southfork dhe mundëm të shikonim shtëpinë e famshme „Ewing”, pastaj pas darkës me barbekju, pas udhëtimit të lodhshëm shkua të pushojmë.

Të hënën fluturova për në McAllen, ku më në fund mundëm të shikonim direkt një pjesë të fushave të kultivimit dhe fabrikën e përpunimit të Aloes. Për ne ishte shumë qetësuese, që gjithshka zhvillohej ashtu sikurse na i kishin përshkruar sponsorit tanë.

Në Dallas pamë fabrikën e ambalazhimit në bidona, ku mundëm të shikonim nga afër fazat e ndryshme të prodhimit. Pame se çfarë theksi i vë FLP çeshtjes të cilësisë. Me teknikën më moderne, me një kontroll të vazhdueshëm të cilësisë. Nuk fshihej asgjë para nesh dhe me sytë e tu mund të shikoje gjithë procesin që nga kultivimi deri tek produkti i gatshëm.

Në Phoenix pamë zyrat qendrore të FLP ku u takuam edhe me drejtuesit e tjerë të kompanisë. Rex me një durim të jashtëzakonshëm, takonte duart dhe bënte foto me secilin nga ne. Të gjithë njerzit bashkë me ne e ndjenim se këtu të respektojnë, respektohet puna që ne kemi bërë. Për ne ka shumë rëndësi kur shohim sa kujdeset FLP për ne. Rex, çdonjerit nga ne do ti thoshte nga një fjalë të dashur, secilit do ti rezervonte një buzëqeshje. Me siguri janë të pakta ato firma në botë ku atmosfera është e drejtpërdrejtë dhe familjare, megjithëse funksionon në 150 vende të botës.

Udhëtimi u mbyll me një argëtim 2 ditor në Las Vegas, që kurorëzoi javën.

Gjatë shkëmbimit të këtij artikulli habitesha se me sa mbësua u pasurova dhe u sigurova se jemi në vendin më të mirë. Gjithkujt i uroj, një herë ta provojë personalisht, çdo të thotë të marrësh pjesë në një Super Rally.

Zsanett Gidófalvi - menaxhere





KISHIM QË NË PRILL QË E PRISIM DITËN KUR MË NË FUND DO TË NISESHIM PËR NË WASHINGTON. UNË KISHA QENË SHUMË HERË NË SHBA, POR KJO ISHTE HERA E PARË, QË ISHTE REZULTAT I PUNËS TONË DHE QË MUND TË UDHËTOJA PËR ATJE ME SHPENZIMET E FIRMËS. ËSHTË NJË KËNAQSI E VEÇANTË QË FLP ËSHTË NJË BIZNES FAMILJARO-MIQËSOR DHE KËSHTU BASHKË ME TIM SHOQ MUNDËM TË MARRIM PJESË NË SUPER RALLY.



SILVER POST

Bahama, Ishulli Paradise, Hotel Atlantis: një vend i merituar për udhëtime lluksi, një kënaqsi prrallore, një diell rrezatues, një det verbues ngjyrë blu... kjo ishte dita e dytë po të flasim natyrshëm. Përshtypjet e shkurtëra se si ishte atje , këtë pervojë do ta ndajnë me ne pjesmarrësit e këtij Silver Post Rally.

„Për mua shumë e rëndësishme ishte që mundëm të udhëtonim bashkë me drejtuesit e firmës. Nga dhomat e hotelit na hapej një pamje fantastike e hotelit luksoz. Shumë i veçantë ishte për ne qëndrimi i firmës që nga momenti i mbërritjes. Dhomat me emrat tona, në dispozicion kishim shoqëruesin turistik, që të na shetiste e tregonte për rreth hotelit me mikrobuz. Shumica jonë ishte me fat sepse që ditën e parë na u prezantua një program fakultativ i siguar nga firma, udhëtuam me anije në një nga ishujt e afërt ku bregu i rërës të imët si pudër ishte i veçantë. Gjithë paraditen bëmë banjë në ujin e ngrohtë të detit. Kur u kthyem nga shetitja me anije na priti lajmi i keq se duhej ta braktisnim këtë vend. Fantastik ishte kujdesi i firmës, që me një punë të zakonshme profesionale dhe pa panik gjatë një nate mori masa që disa qindra pjesmarrës të transportoheshin të sigurtë në Dallas, dhe prej andej në atdhe. Gregg Maughan tha se asnjë nga firma nuk do ta lëmë pas, dhe kështu u bë. Këtë dashuri, kujdes dhe respekt nuk e kisha ndeshur tjetërkund, por e ndjemë tek firma mëmë dhe kudo gjatë udhëtimit tonë në Amerikë.”

Terezia Herman-soaring menaxhere

„Ishujt Bahama dhe Hotel Atlantis, ishte vërtet endërr e një lluksi të veçantë. Ishte e mrekullueshme , megjithse për një ditë rreth hotelit arritëm të shkonim. E paharrueshme pamja nga porti, me qindra jahte oqeanike. Sa keq që stuhia Irene na i ndërpreu në mes dhe na detyroi të largoheshim para kohe. Por mundet që edhe e shumta të bën dëm. Pa qejf u kthyem në Dallas, në Hotelin Southfork . Shpresoj që me ju që lexoni këto radhë të kthehemi qoftë edhe një ditë atje.

Miklós Berkics - diamant menaxher

„Pas 14 vitesh, më në fund, vëllai im erdhi me mua në Amerikë, në këtë udhëtim të mrekullueshëm, dhe kështu bashkë mundëm të perjetonim këto pershtypje që nuk mund të quhen të zakonshme. Në botë, kompania Forever , është firma më e besueshme dhe nëpërmjet distributorëve të saj, përhap qëllimet më fisnike. Ai shqetësim dhe kujdes që pamë në ishujt Bahama ndaj nesh, ishte i veçantë. Qëllimi im është ti ndaj me të tjerët pershtypje të tilla të paharrueshme, sepse kjo është mundshme të arrihet për gjithkënd.”

Agnezs Krizsó - zafir menaxhere



RALLY 2011

„Ditën e hënë, si dhuratë nga Rex, mundëm të merrnim pjesë në një shfaqje delfinësh në pishinë. Të nesërmen në agim kur po prisnim të niseshim, në dhomën tonë dëgjua zërat e delfinëve, edhe ata e ndjenin se diçka e keqe po afrohej. Kur Gregg na njoftoi se udhëtimi ynë do të shkurohet, provuam një ndjenjë të kujdesit të veçantë, dhe kur stuhija Irene vuri këmbët në ishujt Bahama, ne ishim larguar me 4 avionë të vecantë. Edhe në këtë situatë të tensionuar Aidan prapë ishte në humor: e di që ndërtuesve të rrjetit u intereson gjithshka, por kush dëshiron ta provojë nga afër një stuhi dhe dëshiron të qëndrojë, le ta shkruajë këtë në një letër bashkë me atë që është normale.

Nga kjo, qëndrimi ynë atje qe i shkurtër por kujtimet dhe ndjenjat për këtë vend ishin të shkëlqyera. Të lodhur por prapë me buzqeshje na pritën edhe në Dallas. Në këto pak ditë mora trajnimin më të mirë në jetën time; në aeroport duke ndihmuar dhe u kujdesur për njeri tjetrin, provuam dashurinë dhe kujdesin e firmës. U kthyem në atdhe, dhe që nga ai moment për çdo gjë kujdesemi më mirë se sa kisha shpresuar.”

Aranka Vágási , menaxhere diamant-zafir

„Ishte një ndjenjë e vecantë të bëja një udhëtim të tillë me bashkpunëtorët e mi tek të cilët kisha parë rininë time: për 4 vjet kisha udhëtuar në Amerikë shpenzimet e mia, që të mirrja një „Big Picture”. Më dëgjua mua, dhe erdhën me mua të gjithë ata që çdo ditë kishim punuar bashkë, por që kohën private shumë pak e kishim kaluar bashkë. Tani kishim shumë përshtypje nga udhëtimi i përbashkët, në Washingtonin e „bandave” e të aventurave. Qeshëm shumë, hëngrë pica bashkë, shetëm në New York. Në fytyrat e tyre pash të pasqyrohejajo që ndjeja edhe unë > jemi në vendin e duhur, jemi të sigurtë, me një skuadër të mirë dhe një e ardhme e shkëlqyer na pret. Megjithatë shumë shkurt, por një gjë e vecantë udhëtimi në ishujt Bahama, furnizim fantastik, një mundësi programesh fantastike që për fat të keq nga stuhija vetëm pak mundëm të shijonim. Foreveri është VIP, një FIRMË e vërtetë! Për mua e tillë, si edhe familja!”

Tamás Budai - soaring menaxher

„Ajo një ditë e gjysëm në ishujt Bahama ishte një mësim i rëndësishëm ku mundëm të provonim sa na i bën qejfin Foreveri dhe çfarë profesionalizmi ka në firmë. Na shërbyen me një modest maksimum, kur u pa se duhej të largoheshim nga ishulli duke punuar pa kursyer forcën, kohën dhe energjitë, ku brënda një nate organizuan largimin tonë për në Dallas dhe prej andej dërgimin e 600 vetëve në drjtime të panumurta të botës. Ti heqim kapelen firmës, u binda plotësisht se jemi në vend të sigurtë, dhe çështja është vetëm se çfarë duam ne, cili është mendimi ynë për të ardhmen, sepse profesionalizmi dhe përkushtimi i firmës as që diskutohen.”

Róbert Varga , diamant-zafir menaxher

„Udhëtimi ynë në Bahama nisi me biletën e embël të njeriut të qejfit. Ishulli Paradise vërtet ishte vetë Parajsa, dhe po bënim llogari sa ditë do të qëndronim aty, ç`ditë të mrekullueshme do të kalonim, kur natyra na ndërhyri në mes. Njeriu në raste të tilla e kupton sa të vegjël jemi dhe pse natyra drejton gjithshka. Ngjarja më e rëndësishme nga qëndrimi ynë atje ishin ato 15 minuta kur mësuam se do të na evakuonin. U mahnitëm me përkushtimin që tregoi firma ndaj nesh, dhe sa të rëndësishëm na konsideron ajo . Një thirrje e arsyes ishte ajo që zot është natyra dhe jo ne. Me shpirt do të kisha qëndruar në ishull megjithë rrezikun e stuhisë, por fatmirësisht drejtuesit e firmës ruajtën logjikën dhe në vendin tim vendosën ata. Mendoja se FLP e Hungarisë nuk do të jetë në gjëndje që të veprojë kaq shpejt, nuk do të na sigurojë biletat e avionit dhe ne do të mbetemi ca ditë në Dallas. Por firma brënda çastit organizoi kthimin tonë në atdhe, për të cilën u jam shumë mirënjohës. Megjithatë rrushi ishte pak i thartë, por kur zbritëm në aeroportin Ferihegy të Budapestit u binda se sa drejtë kishte vepruar firma me veprimin që bëri. Kam 16 vjet në këtë biznes, por kaq afër nuk kisha qënë me një vendim të drejtë si atje në ishujt Bahama. U binda se Foreveri mendon me largpamje dhe me arsye për fatin tonë dhe për ecjen tonë përpara.”

József Szabó- zafir menaxher





„Një nga endërrat tona të disa viteve më parë ishte Atlantiku, qoftë edhe një anije oqeanike, apo ishujt Hawai, dhe firma sikur të kishte lexuar endërrën tonë, na i plotësoi ato. Një luks i paparë; çdo biznes i markës botërore e tregon veten. Një përshtypje e mrekullueshme duke ngrënë mëngjezin pranë akuariumeve gjigante, ku rajat katër metroshe dhe peshq të tjerë të panjohur notonin në të. Në kopësht nga do që ta vërtitje aparatit fotografik do të kapje pamje mahnitëse të këtij mjedisi prrallor. I paharruar ishte programi shfaqjes me delfina ku luanim në ujë dhe u miqësua me këto kafshë të zgjuara. Sa keq që nuk patëm mundësinë të provonim rrëshqitëset prej një milje e gjysëm. Eshtë i papërshkrueshëm furnizimi me ushqim si princër dhe peisazhi i paparë i detit. Vetëm të thithësh ajrin, vetëm këtë gjë të perjetosh, të mund ta ndjesh dhe që nuk mund ta rrefësh. Sa mbresëlënëse të shikoje punonjsit e Foreverit që punonin ditë e natë për të larguar dhe shpëtuar 600 vetë nga stuhia. Foreveri tregoi edhe një herë çfarë konsiderate ka për distributorët e saj. U lutëm që në këtë situatë ishim pjestarë të Foreverit dhe që i përkasim një skuadre të tillë fantastike”

Tóth Sándor soaring manager

„Për mua udhëtimi në ishujt Bahama për dy gjëra ishte i paharrueshëm. Një anë ajo se sa bujare është kjo firmë, ku distributorët e saj i çon në vende të tilla lluksi duke treguar se sa e vlerëson punën tonë. Nga udhëtimet e Foreverit ky është vendi ku do të rikthehemi sepse është vetë çudia. Për fat të keq nga kjo mrekulli shijua vetëm një ditë e gjysëm, sepse na i ndërpreu stuhia. Përshtypja tjetër e paharrueshme ishte ajo që firma ndaj nesh bëri një gjest fantastik, me një kujdes të vecantë na bindi edhe një herë se jemi me firmën më të mirë në botë, me drejtuesit më të mirë që na ndihmojnë kudo. Unë u sigurova edhe një herë se nuk ka mundësi të tjera si Foreveri !”

Zsolt Leveleki - soaring menaxher

„Ajo që na preku vërtetë, ishte që të shkojmë në vendin më të bukur të botës, ku vëndasit jetojnë në rrethana mjaft të vështira, megjithatë brënda kësaj ekziston një botë e vogël e mbyllur dhe e pasur, gjë që e pasqyron në vetvete edhe Hoteli Atlantis. Këtu mund të gjëndet gjithshka, shkëputja nga shqetësimet e punë, argëtimi dhe pushimi vetëm mund të imagjinohen. Kaluam një ditë të plotë, duke pershkruar këtë ishull të vogël që quhet ishulli i Parajsës. Shumlllojshmëria e bimësisë dhe pasuria magjepsëse e mundësive të argëtimit na bëjnë të biem rob të kësaj bukurie. Njeriu mund të marrë pak diell në plazhin e këtij deti, apo mund të pijë një koktej në krevatin e varur në mes të gjetheve të palmave. Disa qindra metra më tutje mund të notosh me delfinët apo të rrëshqasësh në parkun ujqor. Shokët tanë e kanë provuar, por këtu duhet të mosharrojmë pa përmendur madhësinë e firmës ku për disa orë organizuan shpëtimin tonë nga rreziku i stuhisë. Madhështia e Foreverit qëndron në atë që mbas një pune të lodhshme një vjeçare të kujdesen të organizojnë disa ditë pushimi e stakimi nga shqetësimet e perdritshme dhe me vete të marrim një hambar mundësish dhe kur të kthehemi mbas pushimit, me mendje të kthjellët të mund ti përvishemi përsëri punës. Ndërkohë që shpалosim përshtypjet nga Amerika, nga taraca e hoteit lluksos të Porecit në kroaci shikojmë perëndimin e diellit, me një koktej në dorë. Faleminderit Forever!

Istvan Halmi dhe Rita Mikola Halminé zafir menaxherë



FOREVER 

EUROPEAN RALLY *be free* BUDAPEST 2012

RALLY EUROPIAN BUDAPEST, HUNGARI


24-25 SHKURT 2012

E RËNDËSISHME: NGA BASHKPUNËTORËT E RINJVETËM ATA QË JANË REGJISTRUAR NË KORRIK MUND TË KUALIFIKOHEN

NIVELI 3

Plotësoni 95 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY NETË
- ★ NË HOTEL
- ★ UDHËTIMI ME AVION



NIVELI 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY
- ★ 3 NETË NË HOTEL



NIVELI 1

Plotësoni 20 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ 2 BILETA HYRJE NË RALLY



